



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr.

**VENDIM
PËR FORMIMIN E NËNKOMISIONIT NGA DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE
PËRKUJDESJE SOCIALE**

**Neni 1
Përbërja**

Formohet nënkomisioni nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për regjistrimin dhe arkivimin e lëndëve në përbërje si vijon:

1. Albert Mustafa, kryesues - Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
2. Rozeta Selimi, anëtare - Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e nënkomisionit**

Nënkomisioni nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që konform dispozitave përkatëse ka për detyrë që të bëjë evidentimin dhe regjistrimin e lëndëve të Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale do të barten dhe arkivohen në objektin e ri të Komunës. Nënkomisioni për punën e tij i raporton Komisionit për koordinimin e procesit të arkivimit, zhvendosjes së stafit dhe inventarit të punës në objektin e ri të Komunës, komisioni duhet të përfundoj evidentimin e lëndëve jo më largë se 60 ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr. 112-75495
Lipjan, më 10.12.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

